



GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2023:302722

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05421004

C.nr.242/2024

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA V., gjyqtari Alush Sinani, me bashkëpunëtoren profesionale Dardana Behluli, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.B.nga fshatiV., Komuna V., i përfaqësuar nga G.R., avokat në V., kundër të paditurës Komuna e V.-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi sipas kualifikimit shkollor, vlera e kontestit 779 €, jashtë seancës, me datë 05.03.2024, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. Refuzohet e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit I.B.nga fshati V., Komuna V. me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e V.-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësit, në emër të kompensimit shtesë të të ardhurave personale për licencim, për periudhën maj 2017 deri në dhjetor 2018, përkatësisht për 20 muaj, t'ia paguajë nga 38.95 €, në shumë të përgjithshme 779 €, me kamatë ligjore 8 %, e llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

II. Refuzohet kërkesa e paditësit për shpenzimet e procedurës në shumën 125 €.

Arsyetim

I autorizuari i paditësit, me datë 28.12.2023, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi në bazë të licensimit, vlera e kontestit 779 €.

Me padi, paditësi ka theksuar se ka qenë i punësuar si mësimdhënës në ShFMU "28 Nëntori" në fshatinV., Komuna V. dhe meqenëse është me diplomë të shkollës së lartë pedagogjike, e për të cilin fakt i takon shtesa e të ardhurave personale apo 19 % e pagës bazë prej 421 € në muaj edhe atë, në përputhje me Ligjin e Punës dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK), ndërsa e paditura e ka paguar atë vetëm 41.04 €, duke i mbetur borxh nga 38.95 € për muaj, nga gjykata ka kërkuar që në emër të kompensimit shtesë të të ardhurave personale për licencim, për periudhën maj 2017 deri në dhjetor 2018, përkatësisht për 20

muaj, t'ia paguajë nga 38.95 €, në shumë të përgjithshme 779 €. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, shumën 104 € për përpilimin e padisë dhe 21 € për taksën gjyqësore për padi.

E paditura, në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, me pretendimin se kërkesa nuk është e bazuar në ligj, pasi obligimet e parapara nga Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës duhet të paguhen nga niveli qendror, Ministrinë përkatëse dhe anën tjetër, ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit e kanë shkëputur këtë kontratë andaj rrjedhimisht edhe nuk mund të prodhojë obligim ligjor për të paditurën. Tutje ka theksuar se paditësja ka nënshkruar kontratën e punës sipas kualifikimit mësimdhënës, kriter ky për themelimin e marrëdhënies së punës në bazë të së cilës edhe realizon të ardhura sipas kësaj pozite. E paditura gjithashtu është thirrur edhe në parashkrim të kërkesës së paditësit, duke theksuar se ka kaluar afati i paraparë prej tri vitesh për të realizuar këtë të drejtë andaj, gjykatës i ka propozuar që të refuzojë kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar në ligj. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Pas pranimit të përgjigjes në padi, gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje mund të vendoset pa u caktuar seancë gjyqësore dhe ka gjetur se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë ashtu siç përcaktohet në nenin 399, par. 1 dhe 2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (tutje LPK), sipas të cilit është përcaktuar se: "Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pa themeltë kërkesëpadia. Kërkesëpadia është e pa themeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi apo po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi apo me faktet që janë botërisht të ditura."

Paditësja, bazën ligjore të kërkesës e ka mbështetur në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK) të datës 18.04.2017, përkatësisht në nenin 7.1 ku është përcaktuar se: "Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit edhe atë: Mësimdhënësi me shkollë normale 10 % e pagës bazë; Mësimdhënësi me shkollë të lartë pedagogjike dy vjeçare 19 % e pagës bazë; Mësimdhënësi me diplomë fakulteti 3 dhe 4 vjeçar 27 % e pagës bazë dhe Mësimdhënësi me diplomë 5 vjeçare, master dhe doktoraturë 35 % e pagës bazë", nga e cila kontratë Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), njëanshëm është tërhequr me datë 21.11.2022.

Meqë e paditura është thirrur në parashkrim të kërkesës së paditësit, gjykata vlerësoi afatshmërinë e kërkesëpadisë së saj dhe duke qenë se paditësi ka ushtruar padi me datë 28.12.2023, duke u mbështetur në nenin 87 të Ligjit të Punës, i cili ka përcaktuar se: "Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 (tri) viteve nga

Numri i lëndës: 2023:302722
Datë: 07.03.2024
Numri i dokumentit: 05421004

paraqitja e kërkesës”, dhe duke llogaritur 3 vite mbrapa nga data e ushtrimit të padisë (dhjetor 2023-dhjetor 2020), gjeti se kërkesëpadia e paditësit për kompensim të të ardhurave shtesë në bazë të licencimit për periudhën maj 2017-dhjetor 2018, është e parashkruar.

Meqenëse kërkesëpadia e paditësit kishte të bënte me të holla dhe gjykata refuzoi kërkuesëpadinë në tërësi, lidhur me shpenzimet procedurale, duke u mbështetur në nenin 450 dhe 452.5 të LPK-së, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142 lidhur me nenin 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V.
C.nr.242/2024, Datë 05.03.2024

Gjyqtari,
Alush Sinani

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.